
RECENSIONE

**ETHEM ÇEKU: “KOSOVA NË SFONDIN
E DIPLOMACISË SË JUGOSLLAVISË DHE TË SHQIPËRISË
(1945-1981)”***

Libri i studiuesit të ri kosovar Ethem Çeku është një risi e këndshme në studimet rreth historisë më të re të Kosovës e cila përfshin pothuajse tërë gjysmën e dytë të shekullit të kaluar.

Gjëja e parë thelbësore që të bie në sy në këtë studim është larmia e madhe, gati gjithëpërfshirëse, e burimeve historike. Jo në shumë studime të kësaj periudhe gjen të referuara dhe të shfrytëzuara në thellësi kaq shumë burime historike si arkivat më thelbësore të Shqipërisë, koleksione të rëndësishme nga arkivat e Jugosllavisë, burime autentike nga arkivi i Kosovës, burime shumë të rëndësishme nga arkivat amerikane dhe nga ato ruse etj.

Kjo larmi burimesh ka bërë të mundur që argumentet historike të jenë shumë dimensionale dhe për këtë arsye ky mund të vlerësohet si një studim i mirë e i plotë në krahasim me nivelin ligjor të mundësive për shfrytëzimin e arkivave në momentin aktual. Kjo është ana më e fortë e këtij botimi.

Por përveç materialit të pasur arkivor, autori duke qenë një njohës i mirë i gjuhëve serbisht e anglisht ka analizuar edhe qëndrimet, tezat e konkluzionet e historiografisë serbe, jugosllave, shqiptare dhe të asaj perëndimore. Në këtë mënyrë botimi ka fituar në problematikë, ka të theksuara vlerat polemike, gjë që i shton vlerat e tij shkencore. Autori me zgjuarsi ka mundur ta vendosë drejt çështjen e përpjekjeve të popullsisë shqiptare të Kosovës për çlirim kombëtar në kuadrin e problemeve nacionale në Jugosllavi. Gjithashtu ai ka analizuar me qartësi ndikimin e situatës politike në Ballkan në çështjen e Kosovës, dhe ndikimin e politikës së dy blloqeve kundërshtarë gjatë Luftës së Ftohtë.

Studimi ka një dozë të lartë autenticiteti gjë që përbën gjithashtu një vlerë tjetër të tij e cila e rrit interesin e lexuesve dhe studiuesve për të.

Struktura e studimit është e saktë e menduar mirë dhe e konceptuar në mënyrë moderne e mjaft të volitshme.

Mënyra e parashtrimit të fakteve dhe argumenteve historike është gjithashtu e drejtë. Për këto arsye studimi është tërheqës dhe lexohet me shumë endje. Ai është shkruar me kulturë historike e gjuhësore.

* Kjo recensë është shkruar para botimit të studimit.

Parathënia është shkruar në mënyrë të saktë, koncize dhe profesionale. Ajo e parashtron qartë temën e studimit dhe synimet e tij.

Në kapitullin e parë është dhënë një tablo interesante e politikave të Fuqive të Mëdha në fund të Luftës së Dytë Botërore. Vlen të theksohet se ka mjaft fakte e detaje interesante jo shumë të njohura në historiografinë shqiptare. Kjo pjesë është e bazuar në një literaturë historiografike të pasur, një pjesë e mirë e së cilës është shumë e freskët.

Në kapitullin e dytë "Kosova dhe lufta e ftohtë 1945-1948" pasqyrohet fillimi i luftës dhe pozita e Kosovës në politikën e SHBA e Britanisë së Madhe. Autori ka analizuar në mënyrë interesante varësinë e politikës së E. Hoxhës nga politika jugosllave, marrëdhëniet sovjeto-jugosllave në lidhje me çështjen shqiptare, qëndrimin e Fuqive Perëndimore si dhe pozicionin e Kosovës në këtë kontekst të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave. Ky kapitull ka një informacion të gjerë burimor dhe analiza interesante.

Në kreun e tretë trajtohet çështja e Kosovës në raportet shqiptaro-jugosllave 1948-1960. Autori jep idenë interesante se rezoluta e Byrosë Informative nuk ishte pika e kthesës në prishjen e marrëdhënieve dhe e argumenton këtë me disa mosmarrëveshje më të hershme shqiptaro-jugosllave e sovjeto-jugosllave.

Në këtë kapitull autori shpjegon se politika e qeverisë shqiptare ndaj Kosovës i ishte nënshtruar tërësisht objektivave të Kremlinit, i cili donte ta përdorte pakënaqësinë e shqiptarëve të Kosovës si një faktor për rrëzimin e Titos dhe për zëvendësimin e tij me një udhëheqje prostaliniste. Megjithatë kjo analizë mund të thellohet më tej për të provuar se Stalini e ndaloi kategorikisht E. Hoxhën që të nxiste irredentizmin shqiptar në Kosovë dhe të ndalonte përpjekjet për shkëputjen e Kosovës nga Jugosllavia. Enver Hoxha, sigurisht me qëllim që të ruante pushtetin e tij, e pranoi këtë pozicion.

Të gjitha veprimet e udhëheqjes shqiptare në lidhje me Kosovën i nënshtroheshin urdhëresave të udhëheqjes sovjetike.

Në fakt E. Hoxha i kërkoi Stalinit shkëputjen e Kosovës dhe trojeve të tjera shqiptare nga Jugosllavia, por u detyrua të dëgjonte urdhrin e tij për t'u tërhequr nga ky projekt.

Një informacion interesant dhe një analizë e qartë i bëhet çështjes së Kosovës në përplasjet midis Shqipërisë e Jugosllavisë. Të dy palët u përpoqën të përdorin individë e grupe të veçanta të popullsisë për të minuar politikisht njeri-tjetrin.

Fakte dhe analiza interesante sillen në sythin *Kosova në raportet Shqipëri-Jugosllavi dhe Shqipëri-Bs në vitet 50', 60'*. Jepet situata e tensionuar midis Shqipërisë e Jugosllavisë, qëndrimi i politikës ruse dhe konsekuencat që pati kjo politikë ndaj popullsisë së Kosovës. Ashtu si dhe në kapitujt e tjerë

autori jep një sintezë të konkluzioneve për faktet e paraqitura në këtë kapitull. Këto konkluzione përgjithësisht janë të sakta dhe mjaft të peshuara.

Megjithatë mendoj se vetëm njeri prej tyre, se “Enver Hoxha tërë potencialin e tij e orientoi në luftën për demaskimin e politikës jugosllave ndaj Kosovës ... dhe se Kosova mbeti problem i hapur për Shqipërinë, i cili në faza të ndryshme është parë si çështje e bashkimit kombëtar, si çështje e pakicës kombëtare dhe si një çështje që duhet zgjidhur nëpërmjet një statusi më të avancuar juridik”, nuk më duket i drejtë dhe i argumentuar shkencërisht. Tashmë ka shumë fakte që provojnë se qeveria e E.Hoxhës betejën kundër Titos e zhvilloi kryesisht në planin ideologjik dhe u tregua shumë e rezervuar që të ndërmerre veprime që shkonin në favor të avancimit të statusit të Kosovës. Ajo zbatoi me përpikmëri urdhrat dhe udhëzimet e Kremlinit pasi kështu i shërbente më mirë qëllimit parësor të saj, mbajtjes dhe konsolidimit të pushtetit politik në Shqipëri. Vitet 1949-1960 ishin vite të vështira për qeverinë e E. Hoxhës pasi ajo ishte e izoluar gjeografikisht dhe e kërcënuar ushtarakisht. Në këto rrethana ajo nuk mund të bënte asgjë më tepër se sa të zbatonte urdhrat e Moskës.

Në kreun e katërt të tërheq vëmendjen një informacion dhe trajtim interesant mbi qëllimet dhe pikëpamjet që kishte Tito kur dha urdhrin për ripushtimin ushtarak të Kosovës. Janë theksuar me qartësi dallimet midis statusit të krahinës së Kosovës dhe asaj të Vojvodinës, si dhe ndikimi i tij në robërimin dhe shtypjen e shqiptarëve. Autori ka nënvizuar faktin se vetëm në krahinën e Kosovës nuk u organizuan zgjedhjet e para pas Luftës së Dytë Botërore. Autori tek përfundimet ka referuar si të vërtetë konkluzionin e Adem Demaçit se kushtetuta e vitit 1974 ishte kompromisi më i keq dhe më i dhimbshëm që i bëhej luftës për çlirim e bashkim kombëtar. Në fakt studiuesit më të njohur e më seriozë të kësaj çështjeje kanë arritur në përfundime të tjera të cilat janë shumë më të argumentuara e të balancuara.

Në kreun e pestë “Antagonizmat shqiptaro-serbe rreth kushtetutës së vitit 1974”, autori me shumë zgjuarsi ka nënvizuar gamën e gjerë të ballafaqimit shqiptaro-serb i cili ishte një proces historik i gjatë herë herë i tensionuar e konfliktual, e në ndonjë rast disi më i qetë, por gjithmonë ekzistent dhe konsistent. Në këtë proces shqiptarët përpiqeshin të mbronin dhe afirmonin identitetin e lirinë e tyre, ndërsa serbët përpiqeshin t’i nënshtronin e asimilonin ata. Ky ballafaqim preku të gjitha sferat e jetës politiko-ekonomike e shoqërore duke depërtuar në çdo qelizë të sajë.

Autori ka dhënë një analizë interesante dhe të bazuar të kushteve dhe rrethanave që çuan në kushtetutën e vitit 1974. Ai arrin në përfundimin e drejtë dhe interesant se Jugosllavisë në këtë kohë i nevojitej një situatë paqeje prandaj u lejua një hapësirë e ashtuquajtur demokratike për ndërrimin e pozitës juridike të Kosovës.

Në këtë mënyrë duket se udhëheqja jugosllave bleu kohën për të kaluar sfidat në të cilat u ballafaquan pas ndërhyrjes sovjetike në Çekosllovakë. Një meritë e autorit është se e ka paraqitur dhe analizuar gjendjen në Kosovë dhe pozitën e saj në raport dhe në kuadrin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ndonëse informacioni, për arsye të kuptueshme, është i kufizuar ai është shumë i rëndësishëm.

Një analizë interesante i bëhet "Librit të kaltër" serb, si një përpjekje për të penguar zbatimin e Kushtetutës së vitit 1974 me qëllim që të minohej çdo përpjekje për avancimin e pozitës kushtetuese të shqiptarëve dhe hapësirave të lirisë për ta. Me "Librin e Kaltër", udhëheqja serbe synonte së pari të anulonte kushtetutën e vitit 1974 ose të paktën të pengonte avancimin e mëtejshëm të pozitës së Kosovës drejt statusit të republikës. Kjo është një analizë e re dhe interesante.

Në kreun e gjashtë "Kosova në vitet '60-'70 dhe qëndrimi i Shqipërisë" autori jep një panoramë të gjerë të problemit të Kosovës në kontekstin e shtetndosjes relative të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave në këto vite. Ai ka analizuar me mprehtësi situatën ndërkombëtare të Kosovës dhe Shqipërisë në një kontekst më të gjerë, duke pasqyruar politikën e SHBA, e Fuqive Perëndimore, fqinjëve të Shqipërisë si Greqia e Italia dhe të vendeve komuniste si BS e Kina si dhe impakti i këtyre politikave në situatën e Kosovës e në politikën e shtetit shqiptar.

Për qëndrimin e udhëheqjes komuniste të Shqipërisë ndaj lëvizjes politike në Kosovë në vitet '60 është sjellë një informacion interesant e i detajuar nga arkivi më i rëndësishëm i Shqipërisë për këtë periudhë, Arkivi i KQ të PPSH. Megjithatë ky aspekt i qëndrimit të PPSH trajtohet në mënyrë të dokumentuar, mendoj dhe i sugjeroj autorit që analizën e kësaj çështje ta shtrojë edhe në një këndvështrim tjetër: Ai duhet të analizojë se cilat ishin arsyet që ndihma e PPSH për Kosovën ishte kaq minimale. Në ç'raport ishte kjo çështje me interesat e pushtetit në Shqipëri? A ndikonte fakti se udhëheqja shqiptare e kishte futur vendin në një izolim të thellë ndërkombëtar dhe ishte e diskredituar në arenën ndërkombëtare, si një diktaturë e egër që kishte shtypur brutalisht liritë dhe të drejtat e popullit shqiptar. Marrja e informacioneve nga Kosova e për Kosovën nuk mund të vlerësohet si një ndihmë për avancimin e pozitës së Kosovës.

Një trajtim i vlefshëm dhe i dokumentuar i është bërë qëndrimit të udhëheqjes komuniste shqiptare ndaj kërkesave për republikën e Kosovës. Ajo hezitoi të mbështeste lëvizjen nacionale në Kosovë. Thuhet me të drejtë se qeveria e E.Hoxhës u fokusua më së shumti ose tërësisht në luftën ideologjike si mundësi dhe mjet i jashtëzakonshëm kundër Jugosllavisë së Titos. Autorit do t'i sugjeroja se në këtë drejtim analiza duhet thelluar. Ky qëndrim i E. Hoxhës i shërbente pikësëpari interesave të ngushta të tij për të ruajtur pushtetin. Ai nuk

i acaronte marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe nuk e shtynte këtë të ndërmerre aksione kundërvepruese të forta kundër regjimit të E. Hoxhës. Ndërsa në planin e brendshëm i shërbente regjimit për ta mbajtur opinionin shqiptar nën presion politik, duke shtuar represionin dhe tensionin ideologjik-propagandistik e përdorte si argument për shtypjen brenda vendit.

Autori ka dhënë me realizëm se në vitet 1966-1968, Enver Hoxha ishte kundër republikës së Kosovës, të cilën e quante manovër të revizionistëve titistë për të gënjyer "shovinizmin kosovar". E. Hoxha shprehej se kjo republikë e jashtme shqiptare, e kurdisur nga titistët mund të bëhet qendra e reaksionit kosovar dhe e të arratisurve fashistë, kriminelë lufte shqiptarë që gjenden në Evropë e SHBA. Në këtë kurth nuk duhet të bien shqiptarët e Kosovës. Ata duhet ta luftojnë këtë manovër të titistëve të cilët kanë mundësi ta luajnë këtë letër". Kjo është një sintezë e qëndrimit të E. Hoxhës ndaj Kosovës. Ajo përbën thelbin e politikës së tij antikombëtare e cila kishte vënë mbi gjithçka interesat e pushtetit personal të E. Hoxhës dhe klikës së tij. Autori ka dhënë një informacion interesant i cili e shpjegon këtë përfundim të cilit ai i është shmangur.

Duhet kuptuar se deklaratat propagandistike të E. Hoxhës se çështja e Kosovës do të zgjidhej pas fitores së forcave marksiste-leniniste në Jugosllavi, etj., ishin një demagogji e pastër për të justifikuar kundërshtimin e tij ndaj këtij procesi.

Shumë interesante është edhe trajtesa që i bëhet raporteve midis Enver Hoxhës dhe udhëheqjes kosovare e veçanërisht Fadil Hoxhës në vitet 70. Përmes një dokumentacioni autentik dhe shumë të vlefshëm i cili futet në qarkullin shkencor për herë të parë, autori ka zbuluar se si E.Hoxha ashtu dhe Fadil Hoxha ishin kundër krijimit të republikës së Kosovës. Ky parashtrim i saktë duhet të shoqërohet me një analizë të mëtejshme se çfarë arsyesh ndikonin në këto politika. Gjithashtu duhet marrë me rezerva të mëdha pohimi i autorit se qeveria shqiptare në koniunkturën e kohës, sa herë i krijohej hapësirë, ishte në mbështetje të çështjes së Kosovës përmes formave të ndryshme.

Në kreun e shtatë autori ka analizuar pozitën e Kosovës në raport me zhvillimet politike në Jugosllavi në vitet '70. Raportet kundërthënëse brenda Federatës Jugosllave janë dhënë me realizëm, thellësi dhe koncizitet.

Në sythin *Kosova, lëvizjet nacionale dhe konfliktet brenda Federatës Jugosllave në vitet 70*, paraqitet në mënyrë interesante situata kur nacionalizmi po shpërthente në Jugosllavi dhe po kështu është paraqitur pozita e Kosovës në këtë labirinth kontradiktash që kishin mbërthyer Federatën Jugosllave.

Një informacion befasues jepet për takimin e Karagjorgjeves dhe diskutimin që u bë për Kosovën atje. Aty Tito paraqitet me realizëm si kundërshtar i zgjerimit të hapësirës së lirisë për shqiptarët e Kosovës. Por evidentohet qartë dilema e tij për ta nënshtruar ushtarakisht Kosovën dhe për të

suprimuar autonominë e saj. Këtu bie në sy veçanërisht shqetësimi i Titos për shtimin e interesimit dhe pranisë së vendeve perëndimore në Kosovë.

Në kreun e VIII "Demonstratat e vitit 1981 dhe qëndrimi i Jugosllavisë" janë dhënë burime dhe informacione të vlefshme historike, megjithëse ngjarjet zhvillohen në një periudhë relativisht të afërt kohore.

Qasja jugosllave ndaj ngjarjeve të vitit 1981 ndoshta mund të jepeshin më të plota dhe të mos zinin vendin kryesor reagimet e D. Qosiçit.

Qëndrimi i udhëheqjes kosovare është dhënë më i plotë dhe mjaft interesant.

Edhe masat që mori qeveria jugosllave pas vitit 1981 duheshin analizuar më gjerësisht dhe jo vetëm në platformën politike për aksionin e LKJ-së.

Duhet marrë me rezervë përfundimet se "kryengritja shqiptare e vitit 1981 shënon procesin e fillimit të shpërbërjes së Federatës Jugosllave. Kjo kryengritje e kthen kombin shqiptar në kulturën dhe qytetërimin europërendimor. Bota demokratike perëndimore mbështeti pranverën studentore të vitit 1981. Në të vërtetë asnjëri prej këtyre konkluzioneve nuk është i saktë dhe i argumentuar.

Kreu i nëntë trajton qëndrimin e Shqipërisë ndaj demonstratave të vitit 1981. Duhesh bërë kujdes në trajtimin e organizatave të rezistencës të cilat ishin grupe ilegale majtiste. Aktiviteti i tyre duket se është mbivlerësuar, dhe nuk është dhënë asnjë argument shkencor. Gjithashtu autori nuk mund dhe nuk duhej të citonte vetveten, por burime historike valide.

Konkluzioni se një pjesë e së djathtës shqiptare ishte konsumuar për shkak të lidhjeve të saj gjatë Luftës II Botërore me fashizmin është jo i saktë. Arsyeja kryesore është se e djathta ishte shtypur e shkatërruar pas ripushtimit serb të Kosovës dhe gjatë gjithë periudhës 40-vjeçare.

Po kështu nuk mund të jetë kaq kategorik pohimi se lëvizja e majtë në Kosovë asnjëherë nuk e tkurri nacionalen në favor të klasores. Kjo lëvizje me ngjyrimë të forta ideologjike nuk mund të mos mbartte kufizime e kontraversitete në raport me interesat kombëtare.

Sythi ku trajtohet qëndrimi i Shqipërisë ndaj ngjarjeve të vitit 1981 duhet riparë me kujdes dhe objektivitet. Të gjithë ne do të dëshironim që Shqipëria ta kishte mbështetur aktivisht Kosovën por e vërteta ka qenë ndryshe.

- Duhet bërë qartë dallimi midis politikave të regjimit komunist diktatorial që synonin ruajtjen e pushtetit të tij dhe sigurisë së vendit. Këto janë dy koncepte të ndryshme.

- Për ta plotësuar kuadrin dhe mënyrën e konceptimit të kësaj pjese si dhe të gjithë studimit duhej studiuar edhe një pjesë e literaturës historiografike perëndimore: autorë të tillë si Sojberg, Pano, Biberaj, Bruks etj. etj.

- Duke parashtruar politikën e tërhequr të E. Hoxhës ndaj Kosovës autori thekson se "padyshim, problemet e sigurisë së vendit kishin përparësi ndaj

objektivave të tjera të Shqipërisë në këtë periudhë". Në të vërtetë, siç e kam theksuar më lart, regjimi kishte preokupim kryesor mbijetesën e tij dhe jo sigurinë e vendit dhe interesat kombëtare. Politika e tij duhet analizuar edhe në lidhje me një argument tjetër të rëndësishëm: Me krizën e thellë të brendshme, e cila e kishte çuar regjimin në buzë të greminës. Kjo ishte një krizë e pakthyeshme prej së cilës ai nuk do të dilte më kurrë.

- Në paragrafin e dytë të sythit 9.5. thuhet se "politika e shtetit shqiptar tani ishte e detyruar të kërkojë aleanca për të siguruar mbijetesën e vet dhe për të mbështetur zgjidhjen e çështjes kombëtare". Ky konkluzion është i gabuar. Për të siguruar mbijetesën e vet ajo e thelloi më tej vetizolimimin. Ndërsa ajo asnjëherë nuk e shtroi problemin e zgjidhjes së çështjes kombëtare. Kjo vijë e saj historike e konstante diktohej nga dy faktorë: Së pari nga ideologjia e saj komuniste e cila e konsideronte të huaj e armiqësor çfarëdolloj nacionalizmi; së dyti dhe çka është më e rëndësishme, ajo e ka konsideruar angazhimin në mbështetjen e shqiptarëve jashtë kufijve politikë, si një politikë të rrezikshme që kërcënonte pushtetin e saj.

- Po kështu i gabuar është pohimi se "mbështetja më e madhe për shqiptarët e Kosovës erdhi nga shtetet perëndimore ndaj të cilave Shqipëria u orientua më fort se më parë". Nuk është e vërtetë as njëra e as tjetra.

- Udhëzimet që u jepte E. Hoxha diplomatëve shqiptarë, nuk dëshmojnë mbështetjen e çështjes së Kosovës siç pretendon autori, por ato kishin për qëllim mbrojtjen e pozitave të regjimit që tregon se udhëheqja komuniste shqiptare ishte shumë e frustuar nga demonstratat e vitit 1981.

Akoma më problematik është sythi 9.6. Demonstratat e vitit 1981 dhe ridimensionimi i çështjes shqiptare në Ballkan.

- Autori mendon se izolimi i Shqipërisë ishte një term relativ dhe jo absolut sepse ajo kishte lidhje diplomatike me shumë shtete. Në të vërtetë izolimi i Shqipërisë ka qenë i tillë, gati absolut dhe ndoshta i pashembullt në historinë moderne.

- Ideja e E. Hoxhës për të mos vazhduar marrëdhëniet kulturore me Kosovën e Jugosllavinë për të shmangur akuzat jugosllave, ishin një tërheqje e qartë dhe një përpjekje për t'i shpëtuar presionit jugosllav mbi regjimin e tij.

- Nuk është aspak e vërtetë se politika shqiptare pas ngjarjeve të vitit 1981 fitoi një përparësi të dukshme në raportet ndërkombëtare në raport me Jugosllavinë. Përkundrazi, kriza e thellë e viteve 80 i dobësoi më tej pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë.

- Po kështu është absolutisht i pavërtetë dhe i paargumentuar pohimi se "Shqipëria ishte bërë forca mbështetëse e lëvizjes gjithëpopullore në Kosovë. Në fakt Shqipëria nuk kishte ndikim të ndjeshëm në këto ngjarje. Madje unë kam botuar fakte që udhëheqja komuniste kishte frikë se pas fitores së forcave nacionaliste në Kosovë, me mbështetjen e mundshme të Amerikanëve, radha do t'i vinte përmbyesjes së regjimit komunist të Shqipërisë.

- Po kështu ngjarjet e vitit 1981 nuk ndikuan aspak në përmirësimin e imazhit dhe të thyerjes së izolimit dhe të zbutjes së luftës ideologjike.

Pretendimet për hartimin e një plani ushtarak për çlirimin e Kosovës, janë të paargumentuara. Ato janë vetëm në imagjinatën demagogjike të R.Alisë. Burimet e veçanërisht intervistat duhen marrë me rezervë më të madhe dhe në mënyrë kritike.

Po kështu duhet ndryshuar shumica e përfundimeve të këtij kapitulli pasi ato janë të gabuara.

Botimi është përmbyllur me disa konkluzione të cilat janë të vlefshme por një pjesë e tyre duhen rishikuar në bazë të vërejtjeve që janë bërë në tekst.

Megjithëkëtë pavarësisht nga shkalla e reflektimit të këtyre vërejtjeve ky studim, siç e kam theksuar qysh në fillim mbetet një kontribut shkencor i vlefshëm në historiografinë shqiptare.

Beqir META